



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E AUDITIMIT

R A P O R T F I N A L
M B I
AUDITIMIN E KOMBINUAR (PËRPUTHSHMËRIE DHE FINANCIAR)
TË VEPRIMTARISË NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT
SHKODËR

PERIUDHA E AUDITIMIT – 01.09.2020 deri më 31.12.2022

Grupi Auditimit

Flamur ÇELA

Blerina DERMISHAJ

Alfred SHABANI

Prill 2023

Aneksi 1: PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE.

Në zbatim të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin Publik", të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të MF "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", pika 4.1.12, për përmirësimin e veprimtarisë së institucionit, grupi i auditimit referuar gjetjeve të përshkruara në pjesën e parë "Përmbledhje ekzekutive" dhe të analizuara sipas sistemeve në pjesën IV "Gjetje e konkluzione" sipas nivelit të prioritetit rendit edhe rekomandimet si më poshtë :

Nr.	Rekomandimet	Niveli i riskut
1	Referuar gjetjeve lidhur me procedurat që duhet të ndjekë Institucioni i Prefektit të Qarkut për shqyrtimin e sanksionit plotësues të procesverbaleve të konstatimit të shkeljes që kryhen nga drejtuesit e mjeteve që zotërojnë leje drejtimi të lëshuara nga një shtet i huaj, në bashkëpunim edhe me policinë vendore, të marrë masat e duhura për përmbushjen rigoroze të përgjegjësive institucionale.	I lartë
2	Të hartohet dhe mbahet dokumentacion i plotë lidhur me veprimtarinë e Komisionit të Emergjencave Civile, ku të evidentohet qartësisht axhenta e mbledhjeve të këtij komisioni, listëprezenca e pjesmarrjes si dhe trajtimi e dokumentimi i çështjeve të diskutuara.	I lartë
3	Prefekti Qarkut për rastet e bashkëveprimit me njësitë e qeverisjes vendore për përballimin dhe menaxhimin e situatave të emergjencës civile, të miratojë autorizimin për përfaqësuesin e Institucionit të Prefektit që caktohet në këto raste. Veprimtaria për këto situata të emergjencës civile të jetë e dokumentuar.	I lartë
4	Në përmbushje të përgjegjësive dhe funksioneve që ka Komiteti i Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, drejtuar nga Prefekti i Qarkut dhe për rëndësinë e madhe që ka ruajtja dhe administrimi i këtyre zonave, të shumta për Qarkun Shkodër, të merren masat e duhura që ky komitet të jetë funksional, të mbledhet siç e përcakton baza ligjore dhe të përmbushë rigorozisht përgjegjësitë. Veprimtaria e këtij komiteti të jetë e dokumentuar.	I lartë
5	Të mërren masa të menjëhershme, për ruajtjen në ambiente të siguruara dhe me dokumentacionin përkatës të aseteve pronë e institucionit. Sa i përket mjeteve të nxjerra jashtë përdorimit, të përshpejtohen procedurat për shitjen e tyre, për të mos shuar kosto shtesë për ruajtjen e këtyre aseteve tashmë të nxjerra jashtëpërdorimit dhe minimizimin e risqeve të mundshme për humbje apo dëmtime të këtyre aseteve .	I lartë
6	Për zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të mëparshme, ato që janë në proces dhe për një rekomandim që nuk është zbatuar, nga ana e menaxhimit të lartë të institucionit të përfshihen si pjesë e vecantë e planit të veprimit që do të hartohet për rekomandimet që kanë të bëjnë me gjetjet e rezultuara në këtë auditim dhe të ndiqet e raportohet zbatueshmëria e tyre .	I Mesëm
7	Mbështetur në gjetjet e evidentuara në këtë auditim lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm, për komponentë të vecantë, Aktivitetin e Kontrollit, Menaxhimin e riskut, të merren masat e duhura nga menaxhimi për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm edhe në këto komponentë.	I Mesëm
8	Të merren masat e duhura për realizimin dhe dokumentimin e inspektimeve, sipas planit të miratuar.	I Mesëm

9	Nga ana e sektorit të financës dhe Shërbimeve mbështetëse si dhe titullarit të meren masa për plotësimin e dosjeve me dokumentacion të noterizuar, gjithashtu zbatimimi i bazës ligjore për mardhënit e punës të nëpunësve duhet të jetë prioritet.	I Mesëm
10	Në hartimin në vijim të dokumentacionit por edhe për ato dokumenta që u evidentuan gjatë auditimit, të përkthehen në gjuhën Shqipe, siç parashikon marrveshja. Për gjithë shpenzimet e realizuara në funksion të këtij projekti në vijim, nga personi i caktuar për ndjekjen e zbatimit të projektit, të mbahet dokumentacioni i plotë justifikues siç përcakton baza ligjore dhe marrveshja e nënshkruar.	I Mesëm

Në zbatim të pikës d, të nenit 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike” të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikave: 4.1.12 “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar” të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të miratuar me urdhrin e MF nr.100, datë 25.10.2016, ndryshuar me urdhrin e MFE nr.4 datë 10.01.2020, nga ana Juaj, të miratohet Plani i Veprimit me persona e afate konkrete, për zbatimin e gjithë rekomandimeve dhe të dërgohet zyrtarisht në Drejtorinë e Auditimit në MB, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e Raportit Final të Auditimit.

Mbështetur në pikën 4.1.13.3 “Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”, si dhe të urdhrin të MB nr.268, datë 01.07.2021 “Për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm”, na dërgoni emrin e personit të caktuar nga ana Juaj, që të evidentojë të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm dhe të komunikojë, monitorojë e informojë vazhdimisht Drejtorinë e Auditimit në MB për progresin që është bërë për zbatimin e tyre.

GRUPI I AUDITIMIT

Flamur ÇELA

Blerina DERMISHAJ

Alfred SHABANI